



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 243/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik KTAP, dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik KDTP, dega Prizren, për shkak presionit për të votuar, për Zgjedhjet e Parakohshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik KTAP-së dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2014, subjektit politik KTAP, dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik KDTP dega Prizren, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se në Shkollën Filllore “ Motrat Qirjazi “ në Komunën e Prizrenit , drejtori i kësaj shkolle është Erol Kala, vëllau i kandidatit Ergin Kala nga – KDTP-ja, i cili ka bërë presion ndaj qytetarëve për të votuar kandidatët e këtij subjekti politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik KTAP-ja pretendohen se vëllau i kandidatit Ergin Kala nga KDTP-ja, personi i lartcekur ka bërë presion ndaj qytetarëve që ditën e Zgjedhjeve t`i votojnë kandidatët e këtij subjekti politik.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimore, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it .

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr.243/2014 më datën 09.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*